



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.05.2019, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 15 maj 2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Ky projektligj kalon për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Roland Xhelilaj dhe Majlinda Halilaj.

Mungon:

Klotilda Bushka.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Bashkim Sala – këshilltar i ministrit

Astrit Hado – drejtor në ISSH

Astrit Kuka – përgjegjës sektori në Drejtorinë e Punësimit dhe Aftësimit Profesional

Ali Emini – zëvendës drejtor pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë. Sot kemi për shqyrtim projektligjin “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Përpara se të fillojmë me projektligjin, si fillim duhet të miratojmë procesverbalin e datës 15.05.2019. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky projektligj kërkohet në mënyrë të përsheptuar nga Kryesia e Kuvendit. Projektligji vjen në komisionin tonë për miratim pasi ka kaluar në Komisionin e Ekonomisë dhe në Komisionin e Ligjeve. Komisioni ynë është për dhënie mendimi.

Materialet që keni përpara janë shpërndarë që ditën e enje, ku kemi edhe të gjitha sugjerimet e sindikatave, të cilat kanë ardhur edhe në *email*-et tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i keni përpara. Projektligji bën fjalë për një kategori punonjësish, të cilët kanë vështirësi në profesionin e tyre, si ai minatorëve, naftës e gazit dhe metalurgët. Këto profesione kanë shënuar invaliditet të lartë dhe jetëgjatësi më të shkurtër, krahasuar me profesionet e tjera. Në kushte të tilla vështirësie qeveria e ka parë të nevojshme të bëjë përmirësimet në këtë projektligj.

Për këtë projektligj kemi të ftuar nga Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave Elton Haxhi, zëvendësministër, Bashkim Sala, këshilltar i ministrit, Astrit Hado, drejtor në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Astrit Kuka, përgjegjës sektorit në Drejtorinë e Punësimit dhe Aftësimin Profesional dhe Ali Emmini, zëvendësdrejtore pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Sipas procedurës fjalën e ka zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave për të bërë prezantimin e projektligjit.

Fjala për ju.

Elton Haxhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ministria e Financave ka hartuar një projektligj për trajtimin financiar suplementar për profesionet e vështira dhe shumë të vështira të minatorëve të nëntokës, punonjësve të naftës dhe gazit, si dhe për metalurgët.

Ky projektligj është një trajtim financiar shtesë dhe nuk është një status për këto profesione. Përfshirja në një ligj i të tre profesioneve të vështira është bërë për shkak të

ngjashmërisë në lidhje me vështirësinë e punës dhe brenda këtij dallimi janë bërë dallimet e punëve të vështira dhe shumë të vështira.

Ligji aktual i statusit të naftëtarit fillimisht u projektua me 5 mijë përfitues, por futja në status edhe e punonjësve të industrisë mekanike dhe administratës së ndërmarrjeve të naftës e deformoi thellësisht çështjen e statusit, duke trefishuar numrin e përfituesve. Deformimi, përveçse është sasior, është edhe cilësor, sepse favorizon punonjës të industrisë mekanike, të shërbimeve dhe të administratës që nuk klasifikohen ligjërisht si punë shumë të vështira dhe të vështira, ku minatori hyn nëntokë, naftëtari dhe metalurgu, si dhe profesione të këtyre kategorive.

Duke analizuar vështirësitë e punës së profesioneve dhe kushtet e vështira të punës, u mendua që tre profesionet e vështira dhe shumë të vështira të trajtohen në një ligj të përbashkët për trajtim shtesë.

Arsyeja se përse duhen trajtuar me përfitim shtesë ka të bëjë me vështirësinë e punës së tyre, periudhën e shkurtër të punës për shkak të vështirësisë, pamundësisë fizike për të vazhduar punën, kohën e gëzimit të pensionit dhe jetëgjatësisë së këtyre kategorive.

Projektligji i propozuar përcakton saktë punët e vështira dhe shumë të vështira në naftë, miniera dhe metalurgji, të cilat do të trajtohen duke garantuar trajtim të barabartë bazuar në vështirësinë e punës. Përfshihen nga përfitimi kategoritë që pa të drejtë janë përfshirë në statusin e naftëtarit, pa punuar në naftë; trajton në mënyrë të drejtë me shtesë pensioni të tria kategoritë, duke mos krijuar diferenca ndërmjet tyre, pasi këto shtesa janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe nuk lidhen me kontribute të paguara.

Ky propozim shërben për pensionistët aktualë dhe pensionistët që do të dalin në vitet e ardhshme, deri në një moment të caktuar, duke e bërë këtë skemë të përkohshme. Përkohshmëria e kësaj skeme lidhet edhe me faktin se këto industri tashmë janë të privatizuara, menaxhohen privatisht dhe buxheti i shtetit nuk mund t'i financojë me para publike përfitimet shtesë, jokontributive, që lindin nga puna e paguar nga sektori privat.

Në përfundim, dua të theksoj se në mbledhjen e fundit të Komitetit Kombëtar të Punës, sindikatat përfaqësuese të minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve kanë bërë vërejtje pse po zvarritej miratimi i këtij ligji, i cili është përkrahur prej disa muajsh.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas parashikimeve tona, do të kemi 23 mijë e 400 ish-punonjës, të cilët do të përfitojnë afërsisht 14 milionë dollarë në vit.

Nëse ka pyetje specifike lidhur me këtë projektligj, grupi i përfaqësuesve të ministrisë, si dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera prezente, në varësi të ministrisë, do t'u përgjigjen shqetësimeve apo pyetjeve që mund të keni.

Faleminderit!

Arben Kamami – Mirëmëngjesi!

Ju falënderoj për përpjekjet që keni bërë për realizimin e këtij projektligji kaq të rëndësishëm!

Unë vij nga qyteti i Elbasanit, ku dihet se ka ekzistuar Kombinati i Metalurgjik me një numër shumë të madh punonjësish. Në relacion thuhet që një ish-punonjës i Kombinatit Metalurgjik t'i gëzojë këto të drejta duhet që burrat të kenë 20 vjet punë në profesion dhe gratë 15 vjet. Siç e dimë të gjithë, në periudhën 1992-1993 aktiviteti i Kombinatit Metalurgjik pothuajse shkoi zero dhe më pas vazhdoi gjatë vitit '96 apo '98 me privatizimin e tij nga firma "Kurum" vetëm për një sektor të veçantë. Ndërkohë, profesionet e vështira, siç kanë qenë furnalta, uzina e koksit, fonderitë apo një pjesë e madhe e furrave të çelikut, realisht aktivitetin e tyre e kanë mbyllur rreth viteve 1992-1993. Realisht ish-punonjësit e këtij brezi, pra brezi i moshatarëve të mi, pothuajse nuk përfitojnë nga ky ligj. A mund të rishikohet edhe njëherë mundësia që ky brez të përfitojë nga ky ligj? Unë nuk besoj se numri i këtyre ish-punonjësve është i madh, sepse dihet që kjo kategori, pavarësisht se thuhet se Kombinati ka pasur rreth 12 mijë punëtorë, si brezi im apo brezi i mesëm dhe të gjithë të tjerët, nuk kanë qenë më shumë se 1200 apo 1400 punëtorë. Pra, numri i atyre ish-punonjësve që paguheshin me kategorinë "A", siç quhej në atë kohë, ishte shumë i kufizuar. Për këtë arsye shumë njerëz mund t'i penalizojë kohëzgjatja e punës edhe pse kanë pasur një profesion të vështirë.

Faleminderit!

Astrit Hado - Përshëndetje!

Unë jam Astrit Hado, drejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në lidhje me pyetjet që ngriti deputeti mund të them se për metalurgët, të cilët realisht kanë kryer një profesion të vështirë, është parashikuar që, përveç uljes së moshës së daljes në pension, të përfitojnë edhe trajtimin financiar suplementar. Këtë e përfitojnë të gjithë në masën 0,6% për çdo vit pune që kanë bërë në këtë profesion. Të gjithë ata, të cilët nuk kanë 20 vjet punë, por kanë të paktën 6 vjet, do të marrin 0,6% për çdo vit pune. Kjo do të thotë se të gjithë ata, që kanë punuar të paktën 6 vjet në këtë profesion të vështirë, do të përfitojnë edhe trajtimin financiar suplementar. Pra, në qoftë një njeri nuk ka punuar 20 vjet në furrat e shkrirjes, por ka punuar vetëm 6 vjet, do të marrë vetëm 80% të masës së pensionit.

Në fakt, projektligji që po diskutojmë sot, ka të bëjë me të gjithë ata që përgjithësisht e gëzojnë statusin e pensionistit. Siç edhe ju e përmendët, Kombinati Metalurgjik është privatizuar nga një kompani private, sikundër edhe minierat. Në projektligj thuhet se këto financime, të cilat do të dalin direkt nga buxheti i shtetit, pa u mbështetur në kontribute shtesë

suplementare, do të jepen për të gjithë ata, që kanë punuar dhe kanë kontribuar në atë kohë. Në projektligj është parashikuar se numri i përfituesve të industrisë metalurgjike do të jetë rreth 2500 vetë. Ne besojmë se këtu do të përfshihen të gjithë ata persona, të cilët kanë eksperiencë pune në furrat e shkrirjes dhe në profesionet e vështira, të cilat janë të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

Enver Roshi – A ka pyetje të tjera?

Ju lutem, prezantohuni në fillim.

Ismet Beqiraj – Përsëritje!

Unë jam deputet, ndaj me të drejtën që më jep ligji dhe statusi i deputetit do të marr pjesë gjithmonë në diskutimet e projektligjeve. Në rastin konkret, për mua është një detyrim, nder dhe respekt, të flas për profesionet e vështira dhe të rrezikshme për jetën dhe shëndetin, siç janë minatorët që punojnë nën tokë, punonjësit e industrisë së naftës dhe gazit, si dhe metalurgët.

Para se të drejtoj pyetjet e mia, dua të bëj një parantezë. Me këtë projektligj merr fund saga e implementimit të ligjit “Për statusin e naftëtarit”, sidomos për trajtimin financiar dhe jo vetëm kaq, por i vendos në pozita të drejtpërdrejta detyrimi dhe pune për miratimin e akteve nënligjore edhe institucionet qeveritare, dy ministrinë përkatëse, si dhe ISSH-në. Ligji “Për statusin e naftëtarit” është miratuar dy vjet më parë, por ende nuk është implementuar plotësisht, pasi deri tani është realizuar vetëm shpërndarja e certifikatave të statusit për një pjesë të mirë të punonjësve të këtij sektori.

E rëndësishme është edhe implementimi, sepse, sikurse tha edhe përfaqësuesi i ministrisë, ky projektligj është vetëm për trajtimin suplementar dhe detyrimin për këto profesione të vështira e merr nga buxheti i shtetit. Ky projektligj nuk i prek (kjo duhet theksuar në mënyrë që të dihet nga përfituesit, siç janë minatorët, por edhe naftëtarët) ligjet e veçanta për statuset e tyre, që, përveç shtesës suplementare për pensionin pleqërisë, ata do të kenë edhe benefite të tjera, por që nuk është rasti t’i prek në këtë diskutim në parim.

Unë kam disa pyetje, të cilat i kam bërë edhe gjatë diskutimeve me palët e interesuara. Me cilat argumente ju i përjashtoni nga e drejta e përfitimit të statusit punonjësit, ata të cilët kanë punuar në industrinë e naftës, konkretisht ata që kanë punuar në Institutin e Gjeologjisë dhe Institutin e Teknologjisë?! Sepse pa këto institute nuk do të kishte as industri naftë, as shkencë për naftën, as 12 burime gazi dhe naftë të zbuluara në Shqipëri dhe asnjë rezervë gjeologjike, të vërtetuar tashmë, që janë 430 milionë tonë naftë. Falë kësaj pasurie që është

zbuluar deri tani nga nëntoka jonë, kanë shprehur interes kompanitë më të fuqishme dhe më të besueshme në botë.

A i trajtoni ju këta punonjës të këtij sektori si një administratë formale burokratike, që mbahen me taksat e qytetarëve shqiptarë (kjo ka ndodhur në atë kohë, sepse, fatkeqësisht, në këtë periudhë tranzitore që po kalon Shqipëria, këto institute nuk ekzistojnë më) apo nga buxheti i shtetit, si institute të mirëfillta kërkimore-shkencore?

Nga ana tjetër (këtë do ta diskutojmë edhe kur të shkojmë te diskutimi i ligjit nen për nen), ju fusni konceptin “personel inxhiniero-teknik”. Madje, edhe në relacion lexova se personeli inxhiniero-teknik në administratë është përjashtuar.

Industria e naftës ka një shumëllojshmëri profesionesh dhe organigrama dhe organizimi i këtyre sektorëve ndërthuren me njëri –tjetrin, por a mund të drejtohen ato pa personel inxhiniero-teknik në prodhim? Më vjen keq, por a ka ndonjë deputet në këtë tavolinë, lëre pastaj mediet që jo e jo, apo nga ju përfaqësues që jeni këtu, i cili të ketë punuar në industrinë e naftës? A e dini se çfarë pune bën inxhinieri i një repartit teknologjik në një ndërmarrje prodhimi, qoftë në pozitën e drejtorit, qoftë në pozitën e kryeinxhinierit, qoftë në pozitën e kryetarit të degës? A e dini se çfarë pune bëjnë ata? Ata janë të parët jo vetëm në dhënien e direktivave organizative, por drejtojnë, lëshojnë, ndalojnë, eliminojnë avaritë, shpëtojnë njerëzit nga rreziqet, nga gazi, nga helmimi, nga zjarri e të tjera në këtë industri.

Enver Rroshi – Ka pyetje tjetër?

Atëherë, ju me të drejtë deklaruat në fillim se ky projektligj ka të bëjë vetëm me trajtimin financiar suplementar, është një benefit që i respekton punëtorët e atyre sektorëve për t’i vlerësuar dhe në ligj nuk ndërhyhet, por unë vërej se ligji nr. 8/2017 është prekur thellë, duke ndërhyrë, gati-gati, në disa pika te 6 nene, ndërsa te ligji nr. 150/2014 “Për pensionin e minatorëve” nuk ka ndërhyrje. Pse është bërë kjo, kur thuhet që nuk preken dhe nuk ndërhyhet te statutet.

Elton Haxhi – Kam diçka për të thënë për kriteret dhe më pas kolegët mund të japin edhe ndonjë detaj më tepër.

Siç e thamë edhe në relacion, kriteri kryesor është vështirësia e punës dhe jo kontributi që gjithsecili ka dhënë në shfrytëzimin e burimeve natyrore. Thënë kjo, si institutet, profesionet apo pozicionet që përmendët ju, kanë dhënë një kontribut të padiskutueshëm në shfrytëzimin e burimeve natyrore, por ne nuk po iu japim një shpërblim apo një komision për të ardhurat që ka përfituar shteti shqiptar nga burimet natyrore. Ne po japim një trajtim suplementar për disa profesione që, në natyrën e punës që kryejnë, kanë vështirësi dhe jo për sa kontribut kanë dhënë apo çfarë pjese u takon nga burimet natyrore të vendit tonë.

Të dyja rastet që përmendët ju, sipas kriterëve që ne kemi përcaktuar, nuk klasifikohen si profesione të vështira, ndaj nuk e gëzojnë këtë shpërblim suplementar. Nëse do të kalonim te parimi që përmendët ju, atëherë fusha e zbatimit do të ishte vertikale dhe horizontale, duke kaluar edhe në nivele të larta qeverisjeje, sepse edhe ata kanë marrë, sipas logjikës suaj, vendime të rëndësishme, që i kanë sjellë vendit përfitime nga kjo industri.

Edhe një herë, ne kufizohemi te vështirësia e punës së kryer dhe jo te parimi sa kontribut kanë dhënë ata apo sa të domosdoshëm janë në zinxhirin e krijimit të vlerës nga këto burime natyrore.

Enver Rroshi – Ke diçka për të shtuar?

Astrit Hado – Për sa i përket pyetjes së dytë, futjes së konceptit të personelit të inxhinierëve teknikë dhe pse janë përjashtuar disa nga këta, në germën “c” të nenit 3 janë përcaktuar të gjithë personat që kanë punuar direkt në naftë dhe personeli inxhiniero-teknik i përcaktuar sipas degëve në industrinë e naftës, sipas profesioneve të vështira, siç është shpimkërkimi, sepse edhe inxhinierët kanë qëndruar te gryka e pusit si ata që kanë shpuar pusët, shpim-shfrytëzimi, prodhimi, sizmika, gjeofizika, kanteriali, përpunimi dhe transporti. Nga kjo kategori është përjashtuar personeli inxhiniero- teknik që rri në zyrë, të cilët nuk kanë të bëjnë direkt me naftën, ndërsa inxhinierët ose teknikët, që kanë të bëjnë direkt me kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, janë të përfshirë.

Për sa i përket pyetjes së tretë që ngritët për ndryshimet e ligjit nr. 8/2017 dhe pse nuk janë bërë ndryshime te ligji nr. 150/2014, që flet për minatorët, e para, ligji nr. 150/2014 nuk është statusi i minatorëve, por është një ligj, i cili ul moshën e daljes në pension të ish-minatorëve, nga 60 vjeç në 55 vjeç. Ndërkohë, ligji nr.8 është një status. Statusi në vetvete përmbledh shumë më tepër se një trajtim financiar. Te ligji nr.8/2017 janë prekur vetëm nenet që kanë të bëjnë me përfituesit, siç e tha edhe zoti zëvendësministër, ku janë eliminuar industria mekanike e naftës dhe disa profesione, të cilat nuk janë të vështira dhe nuk lidhen me prodhimin dhe shfrytëzimin e naftës, si dhe masa e përfitimit të trajtimit suplementar.

Në krye të herës desha të shtoja edhe diçka. Ky lloj trajtimi i veçantë jepet nga buxheti i shtetit dhe ka natyrë buxhetore, pra nuk ka natyrë kontributive. Asnjë nga këta që do të përfitojnë, rreth 23 mijë e 500 vetë, nuk kanë paguar asnjë lek kontribut shtesë për ta përfituar këtë pension suplementar. Ky është një trajtim financiar, që parlamenti vendosi t’ua japë këtyre njerëzve për shkak të punës së vështirë që kanë bërë në kohën e shkuar.

Nuk është prekur në asnjë pjesë tjetër statusi i naftëtarit. Statusi i naftëtarit vazhdon t’i ketë të gjitha përcaktimet që ka pasur, me përjashtim të përfituesve. Pra, janë saktësuar përfituesit. E tha edhe zoti zëvendësministër, në fillim u parashikua të ishin 5000 vetë. Në fakt,

kërkesat për të marrë statusin e naftëtarit arritën rreth 13 mijë dhe masa e përfitimi nga 1% ka shkuar në 0,6% për çdo vit pune.

Klodiana Spahiu –Përshëndetje!

Së pari, dua t'ju falënderoj, sepse që prej 27-vjetësh kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e punonjësve që bëjnë punë të vështira, siç janë minatorët, naftëtarët dhe ata që kanë punuar në metalurgji dhe ne arrijmë të finalizojmë një projekt, që ndoshta është punuar nga ju dhe kolegëve tuaj më parë!

Ky projektligj ka hyrë me procedurë të përshpejtuar. Ne kemi pasur disa kërkesa, të cilat na kanë ardhur nga grupet e interesit. Ne nuk kemi mundësi ta realizojmë seancën dëgjimore dhe nuk jemi në dijeni nëse komisioni përgjegjës do ta realizojë ose jo këtë seancë dëgjimore, por do të doja të ndaja me ju një pjesë të këtyre kërkesave, për të kuptuar nëse ka pasur apo jo dakordësi me grupet e interesit.

E para është një kërkesë e invalidëve të punës, të cilët kanë kërkuar që invalidëve, që kanë punuar në nëntokë, me aksident në punë ose sëmundje profesionale, t'u merret për bazë pragu i vjetërsisë së punës me 12 vjet e 6 muaj. Kjo për arsye se invalidët e ndalojnë punën për shkak të aksidentit dhe kjo nuk është dëshira e tyre. Ky është një argument që kanë dhënë ata.

E dyta është një kërkesë tjetër e ardhur nga Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë, të cilët kërkojnë të dinë nëse... Ju keni thënë se duhet të ketë një vjetërsi pune minimumi 6 vjet. Po me këta që kanë 6 vjet e 6 muaj, çfarë do të ndodhë?

Një kërkesë tjetër ka ardhur nga Qendra për të Drejtat në Punë. Në fakt, kërkohet të ndërhyhet në statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, si dhe ulja e afatit kohor të përfitimit të statusit për meshkujt nga 20 vjet në 15 vjet dhe nga 15 vjet në 10 vjet për gratë. Pra, kërkohet ulja e këtij afati kohor (kjo më duket se është një ndërhyrje në status, nuk e di se çfarë opinionit keni ju për këtë) dhe heqja e kushtit të kontributit të sigurimit të përgjithshëm në punë, 30 vjet për meshkuj dhe 25 vjet për gratë.

Dëshira jonë është shumë e madhe që grupi i punonjësve me vështirësi pune që përfitojnë të jetë sa më i madh. Bazuar edhe në ato që tha profesori, mendoj se ne... Kur kemi kaluar statusin, kemi pasur një debat shumë të gjerë, sepse e filluam me një kornizë dhe ajo erdhi duke u zgjeruar, deri sa përfundoi aty ku është sot.

Duke ditur që këto janë para, që në pjesën më të madhe paguhen nga buxheti i shtetit dhe sistemi kontributiv, ashtu siç thatë edhe ju, të paktën për pjesën e pensioneve suplementare, ata nuk kanë paguar më tepër për të marrë më tepër. Mendoj se duhen parë me këtë sy, që më të vërtet ata njerëz, që kanë vuajtur për kaq shumë vite, kanë pasur një shkëputje të

menjëhershme nga tregu i punës dhe kanë marrë një pension minimal, duhen mbështetur. Ky është një vendim shumë i drejtë.

Ju keni bërë edhe konsultime me ta. Në një kërkesë të tyre ata pretendojnë se, së pari, ky ka qenë një vendim për të marrë 40% të pagës minimale. Pastaj, vendimi që ne kemi këtui është 1% për çdo vit vjetërsi pune në minierë.

Në qoftë se ju keni ndonjë shpjegim për këto ndryshime, ju lutem, të na i jepni neve, si komision! Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe shpresojmë që kërkesat e këtyre punonjëseve t'ia kalojmë komisionit përgjegjës. Gjithsesi, ne donim t'i ndanim edhe me ju, për të ditur se çfarë opinionit keni për to.

Bashkim Sala – Jam Bashkim Sala, këshilltar i ministres së Ekonomisë dhe Financave. Mbuloj Sektorin e Marrëdhënieve me Sindikatat dhe Biznesin.

Projektligji është konsultuar për herë të parë në nëntor të vitit të kaluar në Këshillin Kombëtar të Punës, i cili përbëhet nga 7 ministra dhe 10 përfaqësues të sindikatave dhe të biznesit.

Në parim, në mbledhjen e nëntorit, sindikatat ranë dakord me principet e ligjit. Gjatë kohës midis mbledhjes së parë dhe mbledhjes së dytë, janë bërë konsultime të vazhdueshme. Më 30 prill, në Këshillin Kombëtar të Punës, përfaqësuesit e sindikatës së minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve, që janë të përfaqësuar shumë mirë në këtë këshill, i bënë vërejtje kryetares së këshillit, ministres së Financave, se përse po shkon me vonesë në parlament ky ligj. Ndoshta kjo shtytje e tyre e detyroi pastaj qeverinë të kërkonte nga parlamenti ta kalojë këtë ligj me procedurë të përshpejtuar.

Pra, duke e përmbledhur me një fjali, nga ana e sindikatave, projektligji gjen përkrahjen dhe falënderimin e tyre, sepse ato janë të përbëra nga ish-minatorë, të cilët duan të kalojë sa më shpejt ky ligj. Po ashtu, edhe grupe të tjera minatorësh, të prituri në Kryeministri dhe në ministrinë tonë, që i kanë paraqitur edhe me shkrim kërkesat, janë prituri veç e veç dhe me to janë bërë sqarimet përkatëse. Drejtori i institutit, zoti Astrit, i ka prituri vetë këto grupe dhe këdo që ka pasur ankesë ai e ka sqaruar, jo vetëm në përgjithësi, por edhe se cili do të ishte drejtimi personal.

Nëse ke ndonjë gjë për të shtuar...

Astrit Hado - Faleminderit!

Po e filloj nga fundi, me kërkesën e kahershme që ka bërë Konfederata e Sindikatave, e cila ka thënë se përfitimi suplementar duhet të jetë në masën 40% të pagës minimale. Parimisht, invalidët e punës përfitojnë të njëjtin përfitim në bazë të viteve që kanë punuar.

Pyetja që ata ngrenë, në gjykimin tim personal, deri diku është e drejtë, ka të bëjë me faktin se për shkak të aksidentit në punë ata nuk kanë mundësi të plotësojnë 12 vjet apo 13 vjet... Kështu që, në qoftë se ata kanë 5 vjet apo 6 vjet vjetërsi pune, do të marrin vetëm 50% ose 60% të pensionit, ndërkohë që teorikisht ata pretendojnë të marrin shumën e vendosur me ligj, 12,5%.

Do ta mendojmë edhe këtë. Nuk mund t'ju jap një përgjigje të saktë, sepse do të bëjmë disa llogari dhe do të shikojmë se si lëvizin ato, por do ta diskutojmë me kolegët dhe do të japim një opinion.

Për sa i përket kërkesës që ka bërë shoqata (po i marr sipas radhës), e cila thotë se duhet të bëhet ulja e vjetërsisë në profesion për naftëtarët, nga 20 vjet në 15 vjet për burrat dhe nga 15 vjet në 10 vjet për gratë...

Enver Roshi – Më fal! A mund ta thuash se cila shoqatë, sepse kemi një sërë sugjerimesh këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Astrit Hado - Qendra për të Drejtat në Punë.

Ajo është një NGO. Ata thonë se duhet të ulet mosha për përfitim të statusit, nga 20 vjet në 15 vjet për burrat dhe nga 15 vjet në 10 vjet për gratë. Njëkohësisht, ajo që lexoi edhe zonja Spahiu, ata thonë se 30 vjet punë është absurde.

Atëherë, më lejoni t'ju shpjegoj. Këto që thotë shoqata kanë të bëjnë me statusin e naftëtarit, që është te ligji nr. 8/2017 dhe ka të bëjë me kushtin për të dalë herët në pension. Tani, mosha normale e daljes në pension e të gjithë shqiptarëve është 65 vjeç për meshkujt dhe 61 vjeç për gratë. Ndërkohë, kësaj kategorie punonjësish, naftëtarëve, për shkak të vështirësisë, i është ulur me gati 5 vjet dalja në pension. Në qoftë se burrat dalin 65 vjeç në pension, burrat naftëtarë, me 20 vjet punë, dalin 60 vjeç, pra dalin 5 vjet më herë në pension. E gëzojnë pensionin gati me 27% më shumë në kohë se të tjerët ose ne këtu. Ata nuk mund të përfitojnë pafundësisht nga kjo gjë, që të dalin edhe herët në pension, por edhe me 10 vjet punë në naftë. Ndërkohë, sipas nomenklaturës së profesioneve, sot profesioni më i vështirë është puna minator në nëntokë, jo minator në sipërfaqe. Edhe te ligji nr. 150, por edhe te ky projektligj, është parashikuar të kenë 12 vjet e gjysmë punë në nëntokë. Nuk mundet t'ua ulësh naftëtarëve këtë, që është një shkallë më pak në vështirësinë e punës, dhe... Ndërkohë, ata e përfitojnë trajtimin suplementar, edhe në qoftë se kanë 6 vjet vjetërsi pune.

Ka edhe një kërkesë tjetër nga sindikatat, që nga 6 vjet të bëhet 3 vjet.

Gjatë diskutimeve dhe debateve që kemi bërë për këtë projektligj ne si Institut i Sigurimeve Shoqërore kemi konsultuar edhe arkivat tona, ose të paktën atë pjesë të arkivave

që i kemi dixhitale dhe na ka rezultuar se ka persona, të cilët kur kanë bërë stazhin e partisë, kanë qenë kandidatë për anëtar partie, kanë qenë artistë e të tjera, e kanë bërë nëpër miniera, në Priskë, në Valias, në Manëz, që do të thotë nëse do të vazhdojmë kështu, i bie që të marrin edhe disa që mund të jenë “Artist i Popullit” sot ose funksionarë të niveleve të ndryshme statusin e naftëtarit 1%. Është menduar se 6 vjet është një kufi që ka sens, ka kuptim që ta marrin.

Për pyetjen e tretë që ngre sindikata, ata kanë propozuar që masa e përfitimit suplementar të jetë në masën 40% e pagës minimale në shkallë vendi. Të jetë për të gjithë njëlloj dhe të marrin 40%. Me pagën minimale që është sot 26 mijë lekë, i bie të marrin rreth 104 milionë lekë të vjetër shtesë mbi pension. Po ta shumëzojmë me numrin e pensionistëve që janë këtu efekti financiar shkon rreth 3,7 miliardë lekë të rinj në vit. Derisa të shuhet kjo skemë, deri sa të mos ketë më përfitues, do t’i kushtojë buxhetit të shtetit rreth 40-45 miliardë lekë të rinj. Të gjitha janë para jokontributive.

Të nderuar deputetë, kini parasysh se sot Instituti i Sigurimeve Shoqërore trajton me pension rreth 650 mijë pensionistë. Ka një buxhet rreth 133 miliardë lekë, po trajton 650 mijë pensionistë dhe brenda buxhetit të tij, nuk ka vetëm pensione, por ka rreth 63 lloje përfitimesh të ndryshme dhe të natyrave buxhetore që qeveria ia ka ngarkuar Institutit për t’i administruar. Imagjinoni të shtojmë edhe rreth 4 miliardë lekë të rinj çdo vit për këtë gjë! Prandaj është vendosur të ketë një trajtim uniform bazuar te vështirësia e profesionit.

Arben Kamami - Zoti Hado, meqenëse e hapët historinë e statusit, ka ekzistuar edhe një lloj tjetër statusi para viteve ‘90 për ata që mbaronin shkollën e mesme dhe punonin nga 1 në disa raste deri në 3 vjet që përfshiheshin në një profesion të vështirë. Këtyre njerëzve, pasi kanë mbaruar shkollën e mesme dhe arsimin e lartë, kanë bërë disa kohë vjetërsi pune në një nga këto profesione të vështira, a do t’u llogaritet kjo periudhë e stazhit, para arsimit të lartë?

Astrit Hado - Nëse e kuptova pyetjen drejt, mund të them se kjo vjetërsi pavarësisht se ku është kryer për efekt të përlllogaritjes së pensionit të pleqërisë do të konsiderohet si periudhë sigurimi. Nëse ata kanë bërë vetëm 2 vjet stazh dhe kanë vazhduar në një profesion tjetër, nuk kanë vazhduar profesionin e vështirë, nuk u njihet, nëse e kanë vazhduar profesionin e vështirë do t’u njihet, nëse kanë bërë stazhin në shpim, ose metalurgji, do të mbledhen të gjitha periudhat e punës së vështirë.

Adelina Rista – Ju falënderoj dyfish si deputete e Fierit që ka një armatë të tërë naftëtarësh, që kanë përfituar nga statusi i naftëtarit dhe përsëri ky projektligji i ri sjell një trajtim financiar shtesë për këtë shtresë punonjësish dhe jo vetëm për naftëtarët, por edhe për

metalurgët e me radhë për profesionet e vështira! Është një trajtim financiar shtesë dhe jo status. Unë këtu do të qëndroj. Kam një pyetje, nuk e di nëse do të marr përgjigje të saktë: a preket statusi i naftëtarit sot? A do të preket statusi i naftëtarit pasi të fillojë të zbatohet ky projektligj? Do të futen njëlloj të dy në zbatim si trajtim financiar edhe ata që kanë marrë statusin apo presin të marrin statusin, ata që nuk e kanë marrë edhe këta me trajtim financiar shtesë?

Unë flas për naftëtarët, se faktikisht jam lindur dhe jam rritur në Fier, nuk jam larguar asnjë ditë prej tij, e di se çfarë do të thotë të jesh naftëtar, e di fort mirë. Sepse jam familje naftëtari. Ismeti ka qenë drejtor i Uzinës së Përpunimit të Naftës dhe të Gazit dhe e di se çfarë është naftëtari. Kur flasim për naftëtarin (po qëndroj këtu, të më falin metalurgët, qyteti i metalurgëve Elbasani), faktikisht vështirësia qëndron jo vetëm tek ata që kanë punuar në naftë, por edhe te banorët e zonave naftëmbajtëse. Po të jetë për vështirësi edhe ata janë të prekur, ata kanë shkallë vështirësie në zonën ku jetojnë, por profesionet ndahen. Ndahet ai që punon te gryka e pusit, pompisti që është te gryka e pusit, inxhinieri i prodhimit që është te gryka e pusit, inxhinieri i shpimit, i kërkimit, shoferi i makinës agregat, apo shoferi i transnaftës që duhet të çojë astrat e shpimit nëpër puse apo duhet t'i marrë që atje, për t'i riparuar e të tjera profesione nga më të vështira, duhet të ndahen. Sinqerisht them se ky trajtim financiar shtesë është për t'u përshëndetur. Prandaj ju falënderoj, por do qëndroj te ajo që tha zoti Ismet për trupën inxhiniero-teknike të stadiit të lartë, sepse ne në Fier e kemi vuajtur shumë. E kanë vuajtur jo vetëm ata inxhinierë, por edhe familjet e tyre me farë dhe me fis deri te brezi i shtatë që janë internuar, sakatuar dhe u është shkatërruar jeta. "Pse pusi mori flakë? Pse nuk u gjend naftë këtu apo pse nuk u shpua atje?" Janë shpallur si grupe armiqësore apo grupe sabotatore. Këta ishin truri i naftës dhe kanë pasur vështirësi shumë të mëdha është shkallë e lartë vështirësie. Këta punonin si në rrethim në Institutin e Naftës për të bërë studimin e zonës naftëmbajtëse, për të piketuar aty ku do të shpohej, për të shkuar deri te shpimi me sukses i atij vendburimi, ngritja me sukses e pusit dhe nxjerrja deri në prodhim. Nëse një astër shpimi bllokohej në pus, a e dini se çfarë ndodhte? Unë e kam jetuar një jetë të tërë. Këta inxhinierë nuk ndodheshin në shtëpi në çastet më të vështira që mund të kalonte familja apo nuk ndodheshin në shtëpi edhe në çastet më të bukura të familjes, por mund të ishin nga Fieri në pusët e shpimit në Xarrë të Sarandës apo aty ku ishin pusët e shpimit në të gjithë Shqipërinë. Këta ishin truri i naftës. Edhe këta duhet të shikohen se kanë vuajtur vetë, familjet e të gjitha me radhë. Shkalla e vështirësisë, pasi vështirësia nuk është absolute, është relative, ka një relativitet në bazë të profesionit, se cilat janë më të vështira. Ju keni bërë një diferencim, por mbështes edhe zotin Ismet, pasi ai është vetë inxhinier ia atij profesioni dhe ju bëri pyetjen: ku jeni mbështetur që i keni diferencuar apo që keni përjashtuar këtë trupë të Institutit të

Naftës? Ky i fundit ka qenë truri i inxhinierëve, i studiuesve dhe i shkencëtarëve nga ishin, nga nuk ishin, punonin tek Instituti i Naftës në Fier. Ne fierakët e kemi ndjerë thellë deri në kockë naftën në Fier. Jetonim në mëngjes me: “A ka shpërthyer ndonjë pus? Cili? C 37-ta, C 12, ky apo ai?” Skuqte qielli flakë dhe banorët më të thjeshtë vinin për të ndihmuar dhe për të shuar pusin. Pra, edhe ata banorë kishin shkallë vështirësie, vështirësinë e naftës, por punonjësit e naftës, vërtetë kanë qenë heronj dhe pikërisht për këtë duhet të trajtohen. Ndryshe metalurgu që ishte te gryka e furrës nga inxhinieri që ishte jashtë. Është krejt tjetër gjë. Ndryshe minatori që është në nëntokë, ai e ka vështirësinë nga inxhinieri që ishte lart, ndërsa naftëtari, inxhinieri i pusit ishte atje. Do të qëndronte atje derisa të bëhej manovra poshtë që shpoi në pus, apo manovra lart kur ngriheshin astrat. Një astër të krisej dhe të bllokohej pusi, ikte gjysma e qytetit. Pra, shkalla e vështirësisë është shumë e lartë nën naftë. Prandaj si deputete e Fierit, si deputete që përfaqësoj aq shumë naftëtarë them se ky është një trajtim financiar shtesë dhe jo status. Jam shumë dakord dhe ju përshëndes. A do të preket statusi? A do të fillojë të veprojë statusi se vjen kjo shtesë, vepron ky më parë, statusi apo të dy njëkohësisht? Sepse ata që kanë marrë statusin po presin.

Enver Roshi - Ju kërkoj ndjesë.

(Pushim)

Fillojmë pjesën e dytë të mbledhjes së Komisionit të Shëndetësisë.

Në respekt të shoqatave, kanë ardhur disa këtu, ju i keni takuar edhe më parë: Shoqata e Intelktualëve të Naftës, zoti Vlash Nakuçi, Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë, zoti Gëzim Kalaja, Shoqata e Invalidëve të Punës, Shoqata “Qendra për të Drejtat në Punë” dhe Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptarë që na kanë dërguar shkresë, me anë të protokollit të Kuvendit, në adresë të komisionit tonë.

Për të qenë korrektë ju ftoj t’i përgjigjeni pyetjes së deputetes Rista në lidhjen me statusin e një pjese të naftëtarëve, e inxhinierëve apo stafit që u përmend nga deputeti.

Bashkim Sala – E kemi nënvizuar shumë herë përse ky ligj është një ligj i veçantë për trajtimin suplementar të tre profesioneve: shumë të vështira të minatorit nën tokë, të vështirë të naftëtarit dhe të vështirë të metalurgut. Në ligj përqindja respektive është 1% për profesionin shumë të vështirë dhe 0,6% për të tjerat, duke respektuar disa standarde që janë në fuqi.

Ky është një ligj që ka kaluar para dy vjetësh dhe pas tij kanë kërkuar status edhe minatorët. Pra, do të fillonte një përshkallëzim i profesioneve që, gjithashtu, quheshin të vështira, si profesioni i aktorëve të cirkut, solistëve të operës dhe me radhë të tjerët.

Ministria e Financave bën vetëm trajtim financiar. ISSH-ja merret me sigurimet shoqërore dhe pensionet, prandaj dhe kërkesa më imediate dhe e vërtetë e këtyre tri shtresave ishte të kishin një trajtim suplementar në kohën e pensionit që është brenda sferës që mbulon Ministri e Financave dhe ISSH-ja. Tani këto industri janë private, minierat janë private, metalurgjia është private, nafta është private. Statuset e këtyre profesioneve (tani e ka vetëm nafta) nuk ka nevojë t'i caktojë shteti. Kontrata kolektive e punës në momentin që firmoset nga punëdhënësi dhe nga sindikata është ligjore, pra është siç e thotë Kodi i Punës, (aty përfshihen kushtet e punës, paga, sigurimet shoqërore, trajtimi suplementar, rrogat suplementare, trajtimi shëndetësor brenda dhe jashtë shtetit). Të gjitha këto janë sipas standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Natyrisht që ka edhe probleme. Të enjten e ardhshme ne do të gjykojmë (se ekziston një institucion në ministrinë tonë që quhet Arbitrimi) një problem që ka një kompani naftë me sindikatën përkatëse. Pra, janë problematika të cilat i parashikojnë ligjet. Gjithashtu, ne kemi një institucion që quhet ISHP-ja, i cili kontrollon kushtet e punës që nga shëndeti e deri te sigurimet shoqërore në secilën nga këto ndërmarrje.

Për sa i përket specifikisht kërkesave që kanë bërë sindikatat, BSPSH-ja, Gëzim Kalaja kërkoi në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Punës arsyet pse nuk kalon ligji (të cilin ne kaluam para 4 muajsh), ligj i cili ka ndenjur dy muaj në platformën e konsultimit. Sepse minatorët që janë në pension duhet që çdo muaj të përfitojnë diçka, sepse dihet se jetëgjatësia e tyre nuk është normale si e të gjithë të tjerëve.

Praktikisht, ligji na detyron të kemi partnerë sindikatat më të njohura, sindikatat më përfaqësuese.

Për sa u përket vërejtjeve që bën qendra, ajo është gjithmonë në bashkëpunim me sindikatat, me ne, jep disa rekomandime, por nuk kemi ndonjë detyrim që çdo qendër ne duhet ta dëgjojmë, përveçse duhet të dëgjojmë mirë partnerët socialë, pra sindikatat, të cilat i kemi dëgjuar dhe kanë qenë dakord me ne.

Enver Roshi - Nuk kemi pyetje të tjera nga deputetët.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në miratimin në parim dhe nen për nen të projektligjit.

Pra, bëhet fjalë për një kategori punonjësish të ekspozuar ndaj të gjithë agentëve atmosferikë, të temperaturës, të gazrave, të pluhurave, kemi shumë minatorë me silikozë, kanë jetëgjatësi shumë të shkurtër krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë dhe të gjitha këto qeveria i merr në konsideratë.

Urdhëroni, për procedurë!

Ismet Beqiraj – Me qenë se edhe ne kemi amendamente dhe korrigjime përkatëse të neneve, të biem dakord me ju si komision që t’i paraqesim qysh në fillim, apo rast pas rasti?

Enver Roshi – Unë them t’i kalojmë nen për nen dhe aty ku keni diçka jua jap fjalën.

Klodiana Spahiu – Për procedurë, zoti kryetar.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Padyshim, ne do t’i çojmë të gjitha propozimet që na kanë ardhur deri tani në komisionin përgjegjës dhe shpresojmë që të ketë dakordësi edhe me ministrinë përkatëse që të realizohet një pjesë e mirë e kërkesave që na kanë ardhur.

Mendoj që edhe amendimet në nene të caktuara duhet të dorëzohen në komisionin përkatës. Mendoj se do të ishte më e udhës që këto amendime të depozitohen në komisionin përgjegjës.

Enver Roshi – Për procedurë.

Ne nuk synojmë të bëjmë ndryshime substanciale të neneve, por teknialitete që kanë të bëjnë me formulimin ndryshe të projektligjit pa prekur pjesët substanciale të neneve përkatëse.

Klodiana Spahiu – Më falni!

Ne si komision nuk jemi njohur me këto amendime dhe mendoj që edhe për kolegët, edhe për ju si kryetar do të ishte shumë e vështirë që me një të lexuar të amendimit për një minutë të arrijmë të konkludojmë nëse duhet apo jo. Ndaj kërkoj mirëkuptimin e kolegut që nëse do të ishte për amendime sot në këtë mbledhje, të paktën duhej t’i kishim pak më parë në dorë për t’i kuptuar edhe ne vetë.

Ismet Beqiraj – Sipas vendimit që u mor në Kuvend, është lënë që brenda ditës së sotme amendimet e ditës së sotme duhet t’i depozitojmë te komisioni përgjegjës. Kjo ka qenë arsyeja që unë nuk i kam depozituar edhe te ju, sepse unë i kam gati për çdo nen dhe mund t’i depozitoj edhe tani, por meqenëse diskutimi regjistrohet dhe kjo ka një vlerë dokumentare, por edhe një procedurë protokollare për të gjitha amendimet që bëhen.

Pra, unë kam respektuar në mënyrë eksplicite vetëm vendimin që mori Kuvendi në seancën e kaluar.

Klodiana Spahiu – Edhe unë për këtë arsye ndërhyra. Mendoj se do të ishte më mirë të dorëzohen në komisionin përgjegjës dhe të diskutohen pak kohë përpara.

Enver Roshi – Edhe ne kemi sugjerimet tona, teknikalitetet e neneve dhe do të lexoj nga neni 1 deri në fund dhe aty ku keni sugjerime do ta hedhim në votë, nëse jemi dakord apo jo për ta kaluar.

Ismet Beqiraj - Edhe përfaqësuesit e ministrisë, edhe të Sigurimeve Shoqërore le t'i marrin dhe t'i përpunojnë dhe t'i pasqyrojnë kur të diskutohet (me procedurë të përshpejtuar ose te komisioni përgjegjës).

Enver Roshi – Mendoj se Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Ekonomisë, që do të mbledhen nesër, do të jenë më vendimmarrës në krahasim me ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Ju lutem, më shumë e kam për palën përfaqësuese të ekzekutivit.

Klodiana Spahiu – Për procedurë.

Ne mund t'i dëgjomë këto propozime, por do të ishte mirë t'i kishim lexuar ose t'i diskutojmë përpara se të votojmë nenet.

Enver Roshi – Unë propozoj të votojmë në parim ligjin.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Të gjithë keni përpara një tabelë, ku është varianti i qeverisë dhe sugjerimet tona, por pa prekur pjesën themelore të ligjit.

Unë do të lexoj variantin e propozuar nga komisioni.

Ismet Beqiraj - Një sqarim për procedurë.

Se ju na pyetët me se jeni, dhe ne ju thamë se ky projektligj ka kaluar në Këshillin e Ministrave, dhe ne jemi pjesë e qeverisë, kështu që, sa për kujtesë, është vendim i Këshillit të Ministrave për ta kaluar këtë në komisione e në parlament.

Enver Roshi – Ju thashë pak më parë, se nuk preket linja e ligjit. Janë sugjerime, të cilat kanë të bëjnë me teknikalitete të formulimit të ligjit. Në parim vendosim që ligji kalon, por me disa sugjerime përkatëse. Për sa kohë që kolegët të kenë tabelën përpara...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Të gjitha kërkesat e ardhura nga grupet e interesit do t'i bashkëngjiten sugjerimeve tona, për të shkuar në komisionet përkatëse: në Komisionin e Ligjeve dhe Komisionin e Ekonomisë, që do të mbledhet nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komisioni përgjegjës që ka hartuar ligjin do të marrë për bazë edhe sugjerimet e ardhura nga grupet e interesit, sepse është projektligj i hartuar jo nga ana jonë, por edhe nga amendimet e ardhura prej kolegut.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Atëherë, sugjerimet tona:

Neni 1. Qëllimi. Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar i punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit, si dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13. 9. 1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjin 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dakord me nenin 1?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Dakord me nenin 1?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! Kalon!

Neni 2: Përfituesit.

Përfitues, sipas ligjit, janë personat me profesione e punë në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji, të cilëve u njihet vjetërsia në punë dhe periudha e sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, por që njëkohësisht plotësojnë edhe kushte të tjera, të përcaktuara në ligj, si më poshtë vijon:

a-Pensionistët që kanë përfitur pension sipas ligjit nr 4171, datë 13. 9. 1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b-Pensionistët që kanë përfitur pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

c-Punonjësit, që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë.

ç- Punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, personeli inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmik, gjeofizik, kantiere, përpunim dhe transport me naftësjellës e gazsjellës.

d-Punonjësit që kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë e ndërmarrje sipas përcaktimeve të kërësve 3, 8 e 12, të vendimit nr. 526, datë 20. 12. 1958 të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”.

Dakord me nenin 2?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është riformuluar. Nuk ka ndryshim, por vetëm riformulim.

Ismet Beqiraj – Unë kam një amendim të ky nen, kryesisht të germa “ç”, ku thuhet: “Punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, personeli inxhiniero-teknik që ka

punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmik, gjeofizik, kantier, përpunim dhe transport me naftësjellës e gazsjellës.”

Ndryshimi konsiston në faktin që në bazë të variantit të parë të bëhet kjo shtesë: pas fjalëve “gjeofizikë, kantier” të shtohet: “institutet gjeologjike dhe teknologjike”, pasi këto institute...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Institutet gjeologjike dhe teknologjike, pasi këto institute jo vetëm që kanë qenë pjesë, por kanë qenë jobuxhetorë, i shërbenin komplet industrisë së naftës, dhe e gjithë veprimtaria e tyre ka qenë me program dhe me plan prodhimi, me plan shpimi, me metrazhe.

Ose ju edhe jap një variant të dytë përfaqësuesve të qeverisë: të riformulohet komplet germa “ç”. Pa bërë ndryshime të forta, por në një kontekst më të pranuar, sepse unë e kuptoj se kur thuhet fjala “institut” krijohet konotacioni i një administrate burokratike, por nuk është kështu.

“Punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, personeli inxhinieroteknik dhe kërkimor shkencor, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim sizmik, gjeofizik, kantier, përpunim dhe transport me naftësjellës e gazsjellës.”

Pra, pas “personelit inxhinieroteknik” të shtohen vetëm këto fjalë: “dhe kërkimorshkencor”.

Sepse këta kanë punuar atje, në kantier, në ndërmarrje, te pusi, te reaktori, te kolona. Nuk kanë dredhur zinxhirin, sepse nuk kanë qenë administratë formale. Dhe sa bëhet, edhe e përkthyer në vlerë leku? Unë i kuptoj edhe përfaqësuesit, por efekti financiar për kompensimin e tyre është 12 mijë euro në muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju lutem, pas meje mund ta marrësh fjalën!

Deri tani, nga 2300 punonjës, që kanë marrë statusin e naftëtarit, vetëm 196 kanë qenë në institute. Shumica ishte në prodhim. Edhe këta që kanë qenë në institute e kanë filluar karrierën e tyre në prodhim. 370 inxhinierë janë. Të tjerët, rreth 30 % e tyre kanë vdekur, sepse s’desha të përdorja këtë fjalë të rëndë.

Ky është propozimi i parë!

Edhe te germa “d” kam një korrigjim: “Punonjësit të cilët kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë e ndërmarrje sipas përcaktimeve të krerëve 3, 8 e 12, të vendimit nr. 526, datë 20. 12. 1958 të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”.

Pas shifrës romake XII propozoj të hiqet fjala: “të vendimit” dhe të vendoset: “të pasqyrës numër 1 në vendimin” e të tjera e të tjera. Në fund të kësaj fjalie të shtohet edhe fjala: “të ndryshuar”, sepse vendimi nr. 526, datë 20. 12. 1958 ka ndryshuar 48 herë: 34 herë me vendime qeverie, 14 herë me urdhra të përbashkët të Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Kaq për këtë nen.

Arben Kamami – Zoti kryetar, jo se dua të kundërshtoj kolegun, Ismetin, por në qoftë se do të dalim te institutet studimore, atëherë më duhet të them se nuk ka pasur institut studimor vetëm në naftë: ka pasur në Kombinatin metalurgjik, ka pasur disa institute studimore në Tiranë, të cilët direkt apo indirekt i kanë shërbyer prodhimit.

Pra, në qoftë se do ta hapim diskutimin për të gjitha institutet, mua më duket se do të zgjeroheshim shumë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Personelin kërkimor-shkencor duhet ta përfshijmë që nga ministria pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, do ta përfshish që nga sektori i ministrisë që ishte, do ta përfshish deri aty.

Enver Roshi – Ne nuk e kemi tagrin e vendimmarrjes, për shkak se nuk dimë gamën e punonjësve, numrin e tyre, efektet financiare e të gjitha, ndaj unë mendoj që ta kalojmë në parim këtë, ndërsa sugjerimet le të përzgjidhen në komisionin përkatës.

Klodiana Spahiu – Më fal, kryetar, një ndërhyrje për procedurë!

Ismet, të lutem, le të përqendrohemi pak te varianti që ju keni propozuar. Ta lexojmë edhe një herë:

“Punonjësit të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik dhe kërkimor shkencor”. Kaq. Atëherë, mendimi im është që ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! Ju e shpjeguat propozimin tuaj dhe keni të drejtën tuaj. Unë mendoj që ta kalojmë me këtë variant që ka kërkuar kolegu, me të drejtën e shpjegimit ashtu siç na e dha, siç e dha në grup, siç e ka dhënë edhe në mbledhjen e bërë me dy ministrat përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Ministrisë së Energjetikës. Më pas do të jetë vendimmarrja e komisionit përgjegjës nëse do ta pranojë ose jo këtë ndryshim.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, më falni, edhe një argument shtesë, që ta bëjmë të qartë këtë punë. Diku më poshtë thuhet: “Këshilli i Ministrave përcakton me VKM listën e

ndërmarrjeve e të sektorëve që do të përfitojnë”. Kështu, kjo rregullohet me ligj nesër. Nuk thotë “institutet”.

Elton Haxhi – Për procedurë. Nëse këto propozime do t’i paraqiten edhe Komisionit të Ekonomisë, mbase nuk është e nevojshme t’i përsërisim edhe këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht për procedurë. Sepse, edhe ju do t’ia çoni Komisionit të Ekonomisë apo jo? Deputeti është anëtar në atë komision, dhe besoj se do të paraqiten aty, gjatë seancës që është planifikuar për nesër, në mos gaboju. Nuk e di, por gjykojeni vetë.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, këtu ka vetëm korrigjim, në kontekst të teknikalitetit të shkruajtjes së ligjit, sepse duhet të shtohet kjo: të pasqyrës numër 1 të vendimit. Duhet ta them “pasqyra numër 1”, se e ke përmendur diku më lart.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, ajo është për pikën “d”, për metalurgët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe ju lutem, se diku e keni lënë në fund të VKM-së, të 58-ës, diku keni shtuar fjalën “të ndryshuar”, diku nuk e keni shtuar. Le të shtohet kudo.

Enver Roshi – Ne do t’ia kalojmë këtë sugjerim komisionit përkatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kalon neni 2, me sugjerimet përkatëse?

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime: përpara çdo paragrafi vendosen numra, gjithsej 6 pika. Pikat 3 dhe 4, për teknikë legjislativë, riformulohen me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Pika 3. “Për efekt përfitimi, sipas këtij ligji, proceset e punës në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji, pas datës 30.09.1993, do të njihen nëse janë kryer dhe dokumentuar sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958 të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror, si dhe në subjekte private”.

Pika 4. Emërtimet e profesioneve dhe punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në pikën 5, përcaktimi “në pikën 3” zëvendësohet me përcaktimin “në nenin 3” dhe referenca ligjore “sipas nenit 6” zëvendësohet me referencën “sipas nenit 8”.

Në fund të pikës 6, përcaktimi “për këtë ligj” zëvendësohet me përcaktimin “për qëllime të këtij ligji”. A jeni dakord me këto ndryshime?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sektorë dhe brigada. Një ndërmarrje ka sektorë dhe brigada dhe nuk është inxhinieri ai që drejton. Inxhinieri drejton të gjithë korpusin e këtij organizimi. Më lart është përcaktuar shumë mirë, ku thuhet: “Ka punuar drejtpërdrejt në ndërmarrjet e sistemit të industrisë së naftës, shpim, kërkim, shfrytëzim, gjeofizik, gjeologji e të tjerë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk merret ligji me gjëra të vogla, me rregullore, janë VKM-të ato që i definojnë. Kur thuhet kombinati i përpunimit të thellë të naftës, ai ka 20 reparte teknologjike, ka reparte mekanike dhe ka vende pune. Kështu është edhe për brigadat.

Germa “c”, “Periudhat e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit nga personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”, pavarësisht se nuk listohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar”. Edhe kjo duhet futur, sepse nëse nuk e fusim, biem ndesh me një nen më lart, por edhe me VKM-në nr.425 datë 10.05.2017, germa “ç”...

Ismet Beqiraj – Unë e kuptoj këtë, por kjo del jashtë kompetencave tona.

Enver Roshi- Kalojmë te neni 4.

Ndryshimet në nenin 4 janë këto: Paragrafi i parë për teknikë legjislativë riformulohet me këtë përmbajtje: “Personat e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimeve të pensionit për shkak të profesionit apo të shtesës mbi pension kur plotësojnë kushtet, si më poshtë vijon:

Në pikën 1, shkronja “c”, paragrafi i fundit, riformulohet për saktësim të dispozitave referuese me këtë përmbajtje: “Kur nuk plotësohen kushtet sipas shkronjës “b” të këtij neni, periudha e punës, sipas shkronjës “b”, i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në shkronjën “c” të këtij neni. Në këtë rast, kushtet e përfitimit janë ato sipas shkronjës “c”, nënpika “i” deri “iii” ” Kush është dakord me këto ndryshime?

Miratohet.

Neni 5.

Miratohet.

Ismet Beqiraj – Kemi VKM-në nr. 526, e cila është ndryshuar disa herë. Në germën “b” thuhet: “Për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës, të gazit, në profesionet e punëcaktuara në pasqyrën numër 1, punë që hyjnë në kategorinë e parë, kreu II, III dhe IV”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të bëj vetëm një korrigjim te germa “b” e nenit 5, te kategoria e parë e kreut IV, pikat 2, 3 dhe 11. Ndoshta e kam gabim, por e kam marr nga ju, nuk duhet thënë “kreu IV, pikat 2, 3 dhe 11”, sepse nuk është kreu IV, pikat 2 dhe 3. Fjalët “kreu IV, pikat, 2, 3 dhe 11” të zëvendësohen me “kreu XI, pikat 1 dhe 2”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është kreu XI, por kreu IV, pikat 2 dhe 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kreu IV është futur gabim si formulim te projektligji. Kreu IV, pikat 2 dhe 3 nuk janë.

Astrit Hado – Ideja është kjo: sipas nenit 526 “Të gjitha profesionet e punës në naftë janë punë të kategorisë së dytë me përjashtim të 3 profesioneve, pompistë, punonjës kyçi dhe punonjësit e pastrimit të pusit”. Pra, këto profesione janë të kategorisë së parë, si minatorët. Te germa “b”, në qoftë se minatorët dalin 60 vjeç në pension, kurse këto 3 profesione dalin 55 vjeç, sepse janë trajtuar njësoi si minatorët. Kjo është diferenca. Në qoftë se ne kemi bërë ndonjë gabim në përcaktim, do ta shikojmë.

Ismet Beqiraj – Po, e keni bërë gabim. Ja ku e keni.

Ju lutem, kreu XI te pasqyra e parë: “Industria e naftës, brigadat e remontit nëntokë të puseve, operatorë, ndihmësoperator...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se i keni futur, sepse te kreu thoni: “Punët e industrisë së naftës...”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, në qoftë se e keni futur.

Enver Roshi - Atëherë, miratohet.

Urdhëroni!

Arben Kamami – Zoti kryetar, ne nuk jemi komision përgjegjës, ne jemi vetëm komision për dhënie mendimi. Domethënë, të gjitha rekomandimet tona përfundimisht duhen dërguar te komisioni tjetër dhe nuk mund ta zgjidhim sot.

Faleminderit!

Almira Xhembulla – Sigurisht, është shumë i vlefshëm i gjithë ky diskutim dhe ndryshimet që do të pasqyrojë deputeti Beqiraj, por, duke qenë se zoti Beqiraj është anëtar i

komisionit përgjegjës, mendoj se në këtë rast do të ishte më e vlefshme që të gjitha mendimet, që ka, t'i japë te komisioni përgjegjës, ku është edhe anëtar me të drejta të plota. Kam përshtypjen se kjo lloj procedure, që po funksionon sot, është relevante kur deputeti nuk është anëtar i një komisioni përgjegjës apo i një komisioni për dhënie mendimi. Ndërkohë, deputeti vjen nga një komision që është përgjegjës, mendoj se të gjithë kontributin dhe inputet që po jep sot për ndryshim dhe komentet e bëra, edhe nëse ka amendamente, është mirë që t'i trajtojë në komisionin përgjegjës, në mënyrë që ta shikojnë më me detaje, me qëllimin që të reflektohen aty ku duhet dhe si duhet.

Enver Roshi - Masa e përfitimit të shtesës për pensionin e pleqërisë dhe të shtresës për pension invaliditeti: Në pikën 1 të përcaktimit “Masa e përfitimit”, për plotësim sugjerohet të zëvendësohet me “Masa e përfitimit të shtresës për pensionin pleqërisë”. Në germën “a” të pikës 1, termi “ish-punonjës”, sugjeroj të zëvendësohet me termin “punonjësit” dhe pas përcaktimit “të cilit kanë përfituar”, sugjeroj të shtohet “pension pleqërie”.

Në pikën 2 “Masa e përfitimit për invalidët”, sugjeroj të zëvendësohet me fjalët “Masa e përfitimit të shtesës për pension invaliditeti”.

Gjithashtu, për unifikim termash, sugjeroj që termi “përfituesit”, të zëvendësohet me termin “punonjësit”. Pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar”, sugjeroj të shtohet përcaktimi “pension pleqërie” dhe përcaktimi “kanë të drejtën e përfitimit të shtesës”, sugjeroj të zëvendësohet me fjalët “përfitojnë shtesë”.

E hedhim nenin 6 në votim.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7, miratohet sipas variantit të Kryeministrit. Nuk ka ndryshim.

Neni 8, për qëllime të teknikës legjislative, sugjeroj të vendoset numri para 3 paragrafëve të fundit, pra para paragrafëve 3, 4 dhe 5.

E hedhim nenin 8 në votim.

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të nenit, 3 nenit 5, pika 1, germa “c”, nenit 8, pika 5, neneve 10 dhe 13 të këtij ligji”.

Kush është dakord me këtë sugjerim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Hyrja në fuqi”. Ky nen nuk ka ndryshime.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA